

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-083/15

**Prishtinë,
11 tetor 2017**

Në çështjen juridike të:

Sh. G.

Pala ankuese/ Pala përgjegjëse në kërkesë

kundër.

M. J. në emër të babit të ndjerë J. J.

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), KPCC/D/A/235/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA14270) të datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 11 tetor 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Sh. G. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/235/2014 të datës 30 Prill 2014 për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA14270.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/235/2014 i datës 30 Prill 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA14270.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 20 shtator 2006, M. J. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në emër të babit të tij të ndjerë, J. J. në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) ku kërkon ri-posedimin e pronës në ngastrën kadastrale 1420/1 në vendin e quajtur Ograda, tokë bujqësore, komuna kadastrale Leshan, e Suharekë/Suva Reka, me sipërfaqe prej 0 h 27 ari e 11 metra katrorë (Më tej “prona e kërkuar”). Ai pretendon se i ati i ndjerë J. J. është pronar i ngastres dhe e ka humbur posedimin në qershor 1999 për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë konfliktin e viteve 1998-1999.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar në AKP:
 - Fletën poseduese nr. 109 të lëshuar nga Departamenti i Zhvendosur i Kadastrit i Suharekës e cila e cekë pronën e kërkuar të regjistruar në emër të atit J.J;
 - Certifikatë vdekje e datës 11 Qershor 2010 me të cilën dëshmohet se pronari J.J. ka ndërruar jetë me 11 maj 1998;
 - Certifikatë pronësie e datës 15 Prill 2014 që deshmon se prona e kërkuar është në e më të të atit të ndjerë;
 - Letërnjoftim i paraqitësit të kërkesës i datës 2 Nëntor 1993 i lëshuar nga administrata e Suharekës
3. Njoftimi i kërkesës ishte bërë më 17 Maj 2007 dhe me 7 Shtator 2011 duke u konstatuar se identifikimi i pronës ishte bërë sakt përmes GPS cordinatave.
4. Sh. G. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) kishte marrë pjesë në procedurën para AKP-së duke pretenduar se prona e kërkuar faktikisht i takonte familjes së tij por se ajo ishte konfiskuar në vitin 1937 deri në vitin 1949 nga regjimi i kohës për arsye se axha i tij ishte shpallur “Kulak” dhe me vendim administrativ i ishin konfiskuar 7 hektarë tokë.
5. Për të mbështetur kërkesën e tij pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar në AKP:
 - Aktvendim Gjykatë së rrethit Suhareke i datës 10 Janar 1950 me të cilin familjes G. i konfiskohej pasuria pa specifikim te ngastrave po me pershkrim dhe sipërfaqe pre 7 hektarë.
 - Kërkesë drejtuar Komisionit për kthimin e tokave të konfiskuara datë 19 Korrik 19 nga familjarët e paraqitësit të ankesës për kthimin e pronës së kërkuar.

- Aktvendim i Komisionit të kthimit të tokave bujqesore i Komunës së Suharekës Nr.460-31-91 i datës 15 Prill 1993 me të cilin familjarëve ju kthehej toka e konfiskuar por nuk përfshihej prona e kërkuar .
6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte verifikuar pozitivisht fletën poseduese dhe certifikatën e pronësisë ku evidentohej babai i ndjerë i paraqitesit të kërkesës si pronar. Sipas detyrës zyrtare Sekretariati i Agjncisë kishte gjetur edhe Aktvendimin Noterial të datës 29 Janar 2013 me numër Nr.LRP.289/2013 reference Trashigimore 028/13 me të cilin paraqitesi i kërkesës tani pala përgjegjëse në ankesë ishte shpallur pronar i ¼ të pronës së kërkuar.
 7. Më 30 Prill 2008, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/13/2008 vendosi që pala përgjegjëse në ankesë e kishte dëshmuar të drejtën pronësore të të atit ndaj pronës së kërkuar dhe vendosi të kthej pronën e kërkuar në posedim të palës përgjegjëse në ankesë. Me resolutën e vet KPCC/RES/24/2010 e kishte prishur vendimin dhe e kishte kthyer në procedurë të përsëritur kërkesën.
 8. Me vendimin e vet KPCC/D/A/235/2014 të datës 30 Prill 2014, KKPK-ja vendosi që pala përgjegjëse në ankesë e kishte dëshmuar të drejtën pronësore të të atit ndaj pronës së kërkuar dhe vendosi të kthej pronën e kërkuar në posedim të palës përgjegjëse në ankesë
 9. Më 13 Nëntor 2014 vendimi i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë. Pala ankuese e kishte pranuar vendimin më 20 Shtator 2014. Ankesa ishte paraqitur më 20 Tetor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese thekson se vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
11. Pala ankuese pretendon të jetë pronar i pronës së kërkuar që i ishte konfiskuar familjes së tij nga ish-regjimi serb pa asnjë vendim mbi Konfiskimin dhe pa kompensim.
12. Sipas palës ankuese, vendimi i Komisionit të kthimit të tokave e ka përfshirë tere pasurine e konfiskuar por Komuna e Suharekës nuk e ka zbatuar vendimin për kthim.
13. Pala ankuese me ankesë kishte bashkangjitur provat e njëjta të cilat ishin prezantuar në shkallë të parë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

14. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se: *Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.*

Meritat e ankesës

15. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave në dosje të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
16. Vendimi i KKKP-së është i drejtë. Gjykata nuk ka mundur të gjejë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
17. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të KKKP-së për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e vërteton të drejtën e tij/saj pronësore mbi pronën private por edhe që ai/ajo aktualisht nuk është në gjendje të ushroj të drejtat e tilla pronësore mbi pronën përkatëse për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
18. Gjykata Supreme vëren se pala ankuese, edhe pse ka pretenduar të drejtën ligjore mbi pronën, nuk ka prezantuar asnjë dokument për të mbështetur të drejtën e tij.
19. Dokumentat e paraqitura nga pala ankuese nuk i referohen pronës së kërkuar dhe fakti i konfiskimit sipas pretendimeve të palës nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga KKKP-ja e as nga Gjykata Supreme për mungesë të legjislacionit dhe të juridiksionit lidhur me konfiskimin. Ligji Nr. 03/L-079 nuk ka mjete ligjore në dispozitiv të palëve për këtë periudhë për shkak të përkuzisimit kohor dhe përmbajtësor të përshkruar në nenin 3.1.1 të Ligjit nr. 03/L-079 .
20. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk ka gjetur *ex officio* asnjë provë që vinte në pikëpyetje të drejtën e palës përgjegjëse në ankesë në rastin në fjalë sepse edhe lista poseduese e zyrës kadastrale para dhe pas konfliktit deshmohet se prona është e regjistruar në emër të babait të ndjerë të palës përgjegjëse. Të njëjtën e konfirmon edhe certifikata e pronësisë e lëshuar nga organi kompetent i Suharekës.
21. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në lidhje me këtë çështje ligjore është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se Vendimi i KKKP-së nuk është kundërshtuar me asnjë provë të vlefshme.
22. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Timo Eljas Torkko, Referent i EULEX-it